



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

Nr. Prot.

12425

Tiranë, më 8 /07/2021

**UDHËZIM PLOTËSUES**

Nr. 20 Datë 8 /07/2021

**“PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM VENDOR  
2022-2024”**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Ministri i Financave dhe Ekonomisë:

**U D H Ë Z O N**

**I. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm vendor 2022 - 2024**

- Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024, të miratuara nga Këshilli i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore do të merren në konsideratë për hartimin e buxhetit të vitit 2022.
- Parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore do të mbështetet në legjislacionin aktual në lidhje me taksat dhe tarifave vendore, si dhe në ligjin nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2022, do të jenë në përputhje me nivelin e financimit të miratuar në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2022-2024, sipas detajimit të parashikimit të dërguar në fazën e parë të PBA-së për vitet 2022-2024.
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionin e arsimit parashkollor për periudhën afatmesme 2022-2024, përfshin edhe rritjen e pagave të akorduar për njësitë e vetëqeverisjes vendore në vitin 2021.
- Formula, kriteret dhe koeficientet e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022 do jenë ato të vitit 2021.
- Niveli i transfertës së pakushtëzuar dhe i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2022-2024, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2021. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar/pakushtëzuar sektoriale do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës financiare përkatëse.

- Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2022-2024 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 7 datë 13.01.2021, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024. Ai pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që njësia e vetëqeverisjes vendore do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
- Këto vlerësime sigurojnë bazën për njësitë e vetëqeverisjes vendore për të përcaktuar tavanet e shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm.
- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në përgatitjen e taveve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 duhet të mbajnë në konsideratë situatën e vështirë financiare të krijuar nga COVID-19, në planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.
- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duhet të përfshijnë në Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.

## II. Afatet për Përgatitjen e Buxhetit

- Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga buxheti i shtetit, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.
- Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik.
- Brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së parë.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 tetor. Në përfundim të këtyre takimeve, sipas rastit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm, brenda datës 20 tetor.

## III. Mbështetja Këshillimore për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e PBA 2022-2024, vë në dispozicion për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore adresat e e-mailit: [Fran.Brahimi@financa.gov.al](mailto:Fran.Brahimi@financa.gov.al), [Elidona.Durmishi@financa.gov.al](mailto:Elidona.Durmishi@financa.gov.al)

